

STATUTI I QENDRËS
"INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË (IDMC)"
"INSTITUTE FOR DEMOCRACY, MEDIA AND CULTURE"

KAPITULLI I
PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 1

KRIJIMI

Në bazë të Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001, "Për organizatat jofitimprurëse", Ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, anëtarët themelues:

JONILA GODOLJA, shtetase shqiptare, [...] e me zotësi të plotë juridike për të vepruar [...].

SONILA DANAJ, shtetase shqiptare, [...] e me zotësi të plotë juridike për të vepruar [...].

MATILDA ALKU, shtetase shqiptare, [...] e me zotësi të plotë juridike për të vepruar [...].

pasi u mbledhën më datë 11.11.2014, vendosën bashkërisht, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të themelojnë organizatën jofitimprurëse pa anëtarësi të quajtur Qendra "**INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË (IDMC)**", i quajtur në anglisht, "**INSTITUTE FOR DEMOCRACY, MEDIA AND CULTURE**".

NENI 2

EMËRTIMI

Qendra do të marrë emrin "**INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË**" dhe në anglisht do të quhet "**INSTITUTE FOR DEMOCRACY, MEDIA AND CULTURE**", me akronimin në shqip dhe anglisht (IDMC).

Do të prezantohet juridikisht me akronimin (IDMC) ose në anglisht (IDMC). Gjithashtu do të ketë një vulë të rrumbullakët, që do të përmbajë shkrimin "IDMC" dhe logon e saj.

NENI 3

BAZAT LIGJORE

Qendra "**INSTITUTI për DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURE (IDMC)**", themelohet dhe krijohet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001, "Për organizatat jofitimprurëse", Ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", dhe do t'i përgjigjet në veçanti rregullores që i jepet në bazë të këtij statuti.

Qendra "**INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË (IDMC)**", është një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim dhe do të ketë shtrirje në të gjithë vendin dhe më vonë edhe jashtë tij.

NENI 4

SELIA

"**INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË (IDMC)**", do të ketë selinë e saj në Tiranë, me adresë Rruga "Qemal Stafa", Pallati 292, Kati i 8, Kutia postare 214, Tiranë dhe do të ketë dhe degë në qytetet brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 5

KOHËZGJATJA

Themeluesit vendosën ta ngrenë Qendrën për një kohë pa limit. Qendra merr statusin e një subjekti juridik dhe fiton personalitetin juridik nga data e themelimit në Gjykatën Kompetente. Qendra do të ketë jetëgjatësi deri në momentin që Organi më i lartë Vendimmarrës i saj të marrë një vendim për ta shkrirë atë. Qendra krijohet për një afat të pakufizuar. Kohëzgjatja

mund të kufizohet me vendim të Bordit Drejtues dhe me pjesëmarrjen e shumicës, ashtu sikundër mund të zgjatet në të njëjtën mënyrë. Përfundimi i veprimtarisë së Qendrës bëhet me vendim të Bordit Drejtues ose me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në nenin 44, të ligjit "Për organizatat jofitimprurëse". Personaliteti juridik i Qendrës mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës për çregjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.

NENI 6

QËLLIMI

IDMC është një person juridik shqiptar, me statusin e një organizate jofitimprurëse, i cili përdor qasje ndërdisiplinare për të studiuar, kuptuar dhe promovuar zhvillimin e vlerave demokratike, rolin dhe impaktin e medias dhe kulturës në Shqipëri. Kjo qendër synon:

- të ndjekë zhvillimet politike e shoqërore në vend me synim promovimin e vlerave demokratike dhe konsolidimin e rendit demokratik;
- të kthehet në një qendër debati kritik dhe kërkimi shkencor mbi aktorët politikë dhe shoqërorë në promovimin e vlerave demokratike;
- të evidentojë dhe dokumentojë zhvillimin e medias si aktore kyçe për demokratizimin e vendit përmes analizës shkencore;
- të shërbejë si një qendër debati dhe kërkimi shkencor mbi rolin e gazetarëve dhe të medias në epokën e sotme të teknologjive të komunikimit;
- të mbështesë artin dhe kulturën, si dhe shkëmbimet kulturore në të gjitha fushat;
- të promovojë diversitetin kulturor dhe tolerancën dhe të kthehet në pikëtakim të kulturave të ndryshme në shkallë lokale dhe ndërkombëtare;
- të ofrojë qasje ndërdisiplinare për trajtimin e temave me rëndësi për shoqërinë shqiptare.

NENI 7

OBJEKTIVAT

Qëllimet e saj Qendra synon t'i përmbushë sipas këtyre objektivave:

- përmes ndërgjegjësimit të publikut për rolin e aktorëve politikë, shoqërisë civile dhe individit në ndërtimin e rendit demokratik
- përmes mbështetjes dhe motivimit të publikut (sidomos të brezit të ri) drejt formave të reja të pjesëmarrjes politike, duke përdorur teknologjinë, mediat e reja (*Fluid Democracy*) në shërbim të rforcimit të demokracisë në shek. XXI
- përmes ndërgjegjësimit të publikut për rolin qeverisës të medias (*Media Governance*) dhe ndikimit të saj në proceset politike, ekonomike dhe shoqërore
- përmes analizës së procesit të komunikimit (procedurat, normat që mundësojnë transparencën dhe llogaridhënien, të drejtën e informimit, autorësisë (*Copyright*) etj.)
- përmes ofrimit të këshillimeve, shërbimeve dhe ekspertizës në fushat e zhvillimit të medias dhe demokracisë në bashkëpunim me institucione të specializuara, operatorë ekonomike, profesionalë dhe të agjencive publike si dhe me qytetarë
- përmes mbledhjes së informacioneve në terren dhe përpunimit cilësor dhe sasior të të dhënave mbi situatën dhe zhvillimin e rendit demokratik në vend
- përmes mbledhjes së informacioneve në terren dhe përpunimit cilësor dhe sasior të të dhënave mbi situatën dhe zhvillimin e medias dhe teknologjive të komunikimit, institucioneve, kornizës ligjore dhe rregullative të medias
- përmes analizave dhe projekteve shkencore që masin impaktin e mediave të reja dhe teknologjive inovative të komunikimit brenda dhe jashtë vendit
- përmes sondimit të opinionit publik për çështje të ndryshme të demokracisë, medias dhe kulturës dhe inicimit të debateve dhe dialogut mes aktorëve akademikë, operatorëve të medias, shoqërisë civile, qeverise në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- përmes botimeve profesionale që reflektojnë rezultatet empirike dhe analizat në fushën e ekspertizës në format print apo *online*

- përmes organizimit të konferencave, seminareve, workshop-eve, trajnimeve dhe kurseve kualifikuese brenda dhe jashtë vendit për çështje dhe tematika që lidhen me zhvillimin e demokracisë, medias dhe kulturës
- përmes projekteve zhvillimore të medias lokale si dhe qendrave kulturore lokale dhe periferike
- përmes monitorimit dhe vlerësimit (evaluimit) të aktiviteteve për projekte të të tretëve në fushën e mbështetjes teknike dhe ligjore për zhvillimin e medias, promovimin e demokracisë dhe kulturës
- përmes kontributit pranë institucioneve shtetërore dhe ligjvënëse me ide dhe projekte (*Think-tank Capacity*) në ndihmë për përmirësimin e cilësisë së medias dhe rregullimit ligjor e deontologjik
- përmes mbështetjes së programeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit (p.sh. vendet e Bashkimit Europian dhe të tjerat që nuk janë pjesë e tij) për të ndikuar në një zhvillim më të sigurt dhe të pavarur të institucioneve shoqërore, mediatike, kulturore dhe akademike
- përmes forcimit të bashkëpunimit kulturor dhe edukativ ndërkufitar (*Cross-border Activity*)
- përmes organizimit të aktiviteteve kulturore, festivaleve, workshop-eve, trajnimeve që nxisin dhe inkurajojnë dialogun ndëretnik, ndërkulturor dhe ndërfetar, barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut
- përmes aktiviteteve që evidentojnë kulturën e të rinjve, të mediave të reja (kultura dixhitale), në film, art, muzikë dhe projekte sociale
- përmes aktiviteteve sensibilizuese që e shtojnë brezin e ri të reflektojnë mbi të kaluarën dhe të ardhmen (kultura e kujtesës kolektive dhe individuale), mbi veten dhe tjetrin (fqinj, i huaji)
- përmes mbështetjes së "sipërmarrjes në punën kulturore" (*Cultural Work Entrepreneurship*) dhe politikave kulturore
- përmes vlerësimit me çmime të personaliteteve në fushën e medias dhe të kulturës për kontributin e tyre

NENI 8

PASURIA E QENDRËS

Te ardhurat e Qendrës do të sigurohen nga:

- kontributi fillestar i themeluesve, i përbërë nga një shumë prej 100.000 (njëqind mije) lekë të depozituar në llogari të Qendrës, në një nga Bankat e nivelit të dytë, shumë kjo e cila kalon në pronësi ekskluzive të Qendrës nga momenti i regjistrimit të saj në Gjykatë. Themeluesit zhvishen nga e drejta e pronësisë së kësaj shume në momentin e përcaktuar më lart;
- të ardhura dhe financime nga donatorë vendas dhe të huaj;
- dhurata, ndihma, grante, kontribute dhe sponsorizime nga persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të dhëna pa kushtëzime që bien ndesh me kushtet e këtij statuti;
- programet e financuara nga organizma ndërkombëtare, organizma dhe institucione e fondacione të huaja e kombëtare, borde lokale, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, zhvillimi i leksioneve, ekspozitave etj.;
- burime të tjera financimi, shprehimisht të lejuara prej ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve në fuqi.

NENI 9

KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË

Administrimi i pasurive të Qendrës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe financiare mbahet bilanc i rregullt që miratohet nga Bordi i Drejtoreve. Qendra ka llogaritë e saj bankare që çelen dhe operojnë sipas urdhrave të Drejtorit Ekzekutiv.

Bordi i Drejtorëve dhe donatorët e mundshëm kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjendjes financiare të Qendrës dhe Drejtori Ekzekutiv me stafin i japin ato brenda një afati optimal dhe nëse është e nevojshme i shoqërojnë shpjegimet me fotokopjet e dokumentacionit përkatës.

NENI 10

MIRATIMI I RREGULLAVE TË BRENDSHME

Rregulloret e brendshme të Qendrës dhe degëve të saj, ku përcaktohen normat e funksionimit të sektorëve të ndryshëm të Qendrës, raportet me të tretët, etj. hartohen nga stafi në zbatim të Statutit dhe Aktit të Themelimit dhe miratohen nga Bordi Drejtues.

NENI 11

NDALIMI I SHPËRNDARJES SË FONDEVE

Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Qendrës do të përdoren në mënyrë ekskluzive për zhvillimin dhe zgjerimin e qëllimit të veprimtarisë së Qendrës. Këto të ardhura do të përdoren për qëllime statutorë dhe nuk do t'i shpërndahen themelueses së Qendrës, përveç detyrimeve në formën e pagesave, rrogave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Qendrës.

Çdo veprim i kundërt është plotësisht i pavlefshëm dhe organet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

NENI 12

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të Qendrës janë:

- **Bordi i Drejtorëve**
- **Kryetari i Bordit të Drejtorëve**
- **Drejtori Ekzekutiv**

Bordi i Drejtorëve është Organi më i Lartë vendimmarrës i Qendrës, i cili drejton të gjithë veprimtarinë e Qendrës duke marrë vendime për çështje me synime afatgjata dhe afatshkurtra.

NENI 13

BORDI I DREJTORËVE (BORDI DREJTUES)

Bordi i Drejtorëve konsiderohet i thirrur rregullisht, në thirrjen e parë, në qoftë se është e pranishme shumica e anëtarëve, në thirrje e dytë, sado që të jetë numri i anëtarëve. Ajo vendos rregullisht, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në të dytën, me shumicë votash.

Për ndryshimin e aktit të themelimit ose të statutit si dhe për shpërndarjen e Qendrës duhet prania e të paktën tre të katërtat e anëtarëve dhe votimi pro i shumicës së të pranishmëve.

Bordi i Drejtorëve drejtohet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe në mungesë të tij, nga një person që është pjesëmarrës i ligjshëm, i emëruar nga shumica e të pranishmëve. I takon Kryetarit të Bordit të verifikojë rregullshmërinë dhe mbarëvajtjen e mbledhjes.

Bordi Drejtues është Organi më i Lartë Vendimmarrës i Qendrës dhe do të përbëhet nga 3 (tre) persona (apo më shumë, por gjithmonë numër tek), sipas përcaktimit të themeluesve, anëtarë të zgjedhur nga Bordi Drejtues me propozim paraprak të përfaqësuesve të Themeluesve. Në rast se propozimi i përfaqësuesve të Themeluesve nuk do të pranohet nga Bordi Drejtues, atëherë ky i fundit do të bëjë vetë propozimin për zgjedhjen e anëtarëve.

Anëtarët e Bordit zgjidhen nga Bordi Drejtues për një periudhë 2-vjeçare, me të drejtën e rizgjedhjes.

Bordi Drejtues zgjedh një nga anëtarët e tij si Kryetar.

Anëtarët e Bordit Drejtues nuk paguhen dhe nuk shpërblehen, por kane të drejtë të rimbursohen për shpenzimet e nevojshme në përputhje me rregullat e Rregullores së Brendshme.

Anëtarët e parë të Bordit të Drejtorëve janë:

1. **Jonila Godolja**
2. **Sonila Danaj**
3. **Matilda Alku**

Kryetare e Bordit të Drejtorëve zgjidhet Znj. Sonila Danaj.

Drejtoreshë ekzekutive e Qendrës zgjidhet Znj. Jonila Godolja.

NENI 14

MBARIMI I FUNKSIONIMIT

Anëtarësia në Bordin e Drejtorëve mbaron:

- a) Me dorëheqje, që duhet t'i paraqitet me shkrim Bordit të Drejtorëve ;
- b) Në rast vdekjeje,
- c) Në rast shpërndarjeje, nëse anëtari është person juridik ose organizatë ose shoqëri;
- d) Në rast shkeljeje të Statutit të Qendrës;
- e) Në rast përjashtimi, që duhet të vendoset nga Bordi i Drejtorëve, me një shumicë prej 3/4 të anëtarëve të tjerë të Bordit të Drejtorëve.

NENI 15

KRYETARI I BORDIT TË DREJTORËVE

Kryetari i Bordit të Drejtorëve mbikëqyr dhe kontrollon realizimin e rregullt të veprimtarisë së kryer nga Drejtori Ekzekutiv, shqyrton dhe miraton kryerjen e detyrave financiare dhe të administrimit me rëndësi të veçantë për Qendrën.

Kryetari i Bordit të Drejtorëve, në rast se konstaton shkelje të rënda nga Drejtori Ekzekutiv gjatë kryerjes së detyrave të tij, mund ta pezulloje atë nga detyra.

Në rastet e paragrafit 2, Kryetari i Bordit të Drejtorëve mund të ushtrojë kompetencat që ky Statut i njeh Drejtorit Ekzekutiv në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet emërimit të një Drejtori të Përkohshëm.

Kryetari i Bordit të Drejtorëve, brenda një periudhe dymujore nga dita e pezullimit, thërret mbledhjen e Bordit të Drejtorëve për të vendosur mbi shkeljet e kryera nga Drejtori Ekzekutiv. Me propozim të Kryetarit ose të anëtarëve të tjerë, Bordi i Drejtorëve mund të vendosë masa disiplinore ndaj Drejtorit Ekzekutiv, të tilla si vërejtje, mbajtje nga shpërblimi apo shkarkimi i tij.

Në këtë mbledhje, Drejtori, që njëkohësisht mban detyrën e Drejtorit Ekzekutiv, nuk ka të drejtën e votës.

NENI 16

DREJTORI EKZEKUTIV

Bordi i Drejtorëve ka emëruar në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv Znj. JONILA GODO-LJA, shtetase shqiptare, [...] e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, [...].

Drejtori Ekzekutiv është emëruar për një periudhë trevjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Drejtori Ekzekutiv ka të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e Qendrës, që hyjnë në objektin e saj, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji ose statuti ja rezervon Bordit të Drejtorëve.

Në veçanti, Drejtori Ekzekutiv kryen këto detyra:

- a) Realizon drejtimin e veprimtarisë së përditshme të Qendrës;
- b) Merr vendime në përputhje me prioritetet e përcaktuara së bashku me Bordin Drejtues;
- c) Përgatit në kohë planin vjetor të punës, planin buxhetor dhe kontrollon zbatimin e tyre;
- d) Përgatit bilancin e kaluar dhe të ardhshëm të Qendrës;
- e) Miradministron mjetet në pronësi të Qendrës;

- f) Merr vendime në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me drejtimin e Qendrës;
- g) Përfaqëson Qendrën në marrëdhëniet me institucionet e ndryshme dhe me persona të tretë, brenda dhe jashtë vendit.
- h) Çdo detyrë tjetër që sipas ligjit ose nga Statuti nuk përbën kompetencë të Bordit të Drejtorëve dhe që lidhet me zbatimin e qëllimit të Qendrës.

NENI 17

TË DREJTAT E PËRFAQËSIMIT

Drejtori Ekzekutiv ka të drejtën për të përfaqësuar Qendrën përpara të tretëve dhe në gjykim, si dhe të drejtën për të firmosur çdo akt që ka të bëjë me administrimin, në emër të Qendrës, në të gjithë territorin kombëtar dhe jashtë tij.

Drejtori Ekzekutiv mund të përfaqësojë Qendrën duke nënshkruar në emër të saj të gjitha aktet me përmbajtje ekonomike dhe të natyrës administrative dhe kontabile, të cilat në mënyrë ilustruese kanë të bëjnë me:

- a) Mbledhjen e shumave të atribuara Qendrës, me çdo mënyrë të ligjshme, nga subjekte publike apo private, shqiptare ose të huaja, me të drejtën për të lëshuar dëftesën përkatëse;
- b) Pagesën në para, me transfertë ose çek bankar qarkullues ose postal të shumave që duhet t'i paguhen Qendrës në çdo mënyrë të ligjshme, me detyrimin për të kërkuar dëftesën ose faturën përkatëse;
- c) Hapjen e llogarive rrjedhëse postale ose bankare dhe të depozitave të çfarëdolloji,
- d) çfarëdolloj operacioni tjetër bankar që ka të bëjë si me sigurimin, ashtu edhe me përdorimin e fondeve, duke kërkuar adresën e dokumenteve përkatëse në emër të Qendrës;
- e) Dokumentet nga entet publike ose private dhe në veçanti bilancin, për të proceduar në dhënien e fondeve për Qendrën;
- f) Çdo dokument tjetër të karakterit administrativ, kontabël ose fiskal të kërkuar nga Entet Publike ose Private.

Në kuadrin e kompetencave të tij, Drejtori Ekzekutiv mund t'i delegojë të tretëve përmbushjen e disa akteve specifike ose kategori aktesh, duke u dorëzuar atyre prokurën e nevojshme për të nënshkruar në emrin e Qendrës.

Sekretari kujdeset për dërgimin e lajmërimeve, hartimin e procesverbaleve, mban librin e anëtarëve të Qendrës dhe kryen çdo funksion tjetër që i besohet nga Drejtori Ekzekutiv.

NENI 18

MBARIMI I DETYRËS DHE SHKARKIMI

Funksioni i Drejtorit Ekzekutiv mbaron:

- a) Me dorëheqjen e paraqitur me shkrim Bordit të Drejtorëve;
- b) Me mbarimin e mandatit;
- c) Në rast të paaftësisë mendore apo fizike për kryerjen e detyrave të tij;
- d) Me vdekjen e tij.

Në rastin e vdekjes, dorëheqjes apo paaftësisë mendore apo fizike të Drejtorit Ekzekutiv në kryerjen e detyrave të tij, do të aplikohen dispozitat e nenit 14 të këtij akti.

NENI 19

BILANCI

Viti ushqimor i Qendrës fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti.

ÇDO VIT, brenda 20 Nëntorit, Drejtori Ekzekutiv siguron dhe depoziton pranë selisë së Qendrës bilancin e vitit ushtrimor të shkuar dhe të ardhshëm.

Ky bilanc i nënshtrohet miratimit të Bordit të Drejtorëve që do të mblidhet brenda një muaji nga depozitimi i mësipërm.

Në fund të çdo viti ushtrimor, Drejtori Ekzekutiv do të sigurojë bilancin përfundimtar të vitit të shkuar, duke e pajisur me raportin mbi ecurinë e drejtimit të Qendrës. Bilanci përfundimtar i vitit të shkuar hartohet brenda muajit Shkurt të secilit vit, depozitohet pranë selisë së Qendrës dhe i nënshtrohet miratimit të Bordit të Drejtorëve që thirret pas 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga ky depozitim.

NENI 20

SHPËRNDARJA E QENDRËS

Shpërndarja e Qendrës vendoset nga Bordi i Drejtorëve.

Në rast shpërndarjeje, sendet e paluajtshme do t'i kalohen, pas pagesës së të gjithë detyrimeve të mundshme, Qendrave ose Enteve që kanë qëllim të njëjtë me atë të Qendrës dhe jo qëllim fitimi.

Për këtë qëllim, Bordi i Drejtorëve mund të emërojë një ose disa likuidatorë, duke përcaktuar të drejtat dhe numrin, si dhe duke formuluar udhëzime lidhur me destinacionin e pasurive që mbeten.

NENI 21

DISPOZITA E FUNDIT

Për gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Kodit Civil Shqiptar, Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" dhe ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".

Ky statut i hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, pasi iu lexua me zë të lartë themeluesve dhe u gjet në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua në prani të time në Noteri dhe unë i vërtetoj këto nënshkrime sipas ligjit.

NENI 22

KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES

Bordi Drejtues përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij, vendos për:

- Ndryshimin e statutit;
- Shpërndarjen e Qendrës;
- Përcakton fushat dhe programin e veprimtarisë së Qendrës dhe degëve të saj;
- Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit;
- Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Qendrës dhe shpenzimet e saj;
- Miraton bilancin e vitit të kaluar dhe të ardhshëm të çdo viti;
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës organizative të Qendrës;
- Zgjedh, emëron dhe shkarkon anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv (Kryetarin dhe Drejtorin Ekzekutiv);
- Krijon komitete të posaçme si dhe çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut;
- Merr vendim për shpërndarjen, bashkimin ose transformimin e Qendrës në një organizatë të një forme tjetër;
- Vendos për krijimin e degëve ose filialeve në rrethe ose jashtë vendit;
- Vendos për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike nga Qendra sipas ligjit me qëllim gjerimin e të ardhurave;
- Miraton aktivitete për mbledhjen e fondeve sipas nenit 37 të ligjit "Për organizatat jofitimprurëse";
- Emëron likuiduesit;
- Shqyrton raportin e likuiduesve;

- Vendos për kalimin e pasurive në subjekte të tjera në rast shpërndarjeje të Qendrës, si dhe për
- Të gjitha rastet e tjera të parashikuara në Statut dhe në ligj.

Në çdo rast, për vendimmarrjen në lidhje me pikat 1 dhe 2 të kësaj dispozite të Statutit, Bordi duhet të ketë marrë më parë miratimin e përfaqësuesve të themeluesve.

NENI 23

RREGULLAT PËR MBAJTJEN E MBLEDHJEVE

Bordi i Drejtorëve të Qendrës përbëhet nga të gjithë drejtorët dhe thirret nga Kryetari i tij të paktën dy herë në vit për të shqyrtuar çështje të cilat janë në kompetencat e tij në përputhje me ligjin dhe Statutin. Gjithashtu ai mund të thirret në çdo moment për nevoja të posaçme kur e kërkon shumica e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Mbledhja e Bordit Drejtues është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Në mbledhjen e Bordit merr pjese dhe Drejtori Ekzekutiv apo persona të tjerë të ftuar, pa të drejtë vote.

Njoftimi për mbledhjen e Bordit bëhet nga Kryetari, 1/3 e anëtarëve dhe nga Drejtori Ekzekutiv.

Bordi i Drejtorëve thirret nëpërmjet një lajmërimi dërguar me letër të thjeshtë të paktën 15 ditë para ditës së mbledhjes dhe i drejtohet të gjithë anëtarëve të Bordit. Lajmërimi duhet të përmbajë ditën, orën, vendin dhe çështjet që do të diskutohen, si dhe datën e thirrjes së dytë nëse e para nuk zhvillohet. Data e njoftimit dhe rendi i ditës mund të njoftohen edhe nëpërmjet postës elektronike secilit prej anëtarëve.

Mbledhjet e Bordit

Rregullat e detajuara të mbajtjes së mbledhjes së Bordit të Drejtorëve do të specifikohen në Rregulloren e Brendshme, e cila do të miratohet/ndryshohet kur konsiderohet e arsyeshme nga Bordi i Drejtorëve.

NENI 24

VENDIMMARRJA

Vendimet e Bordit Drejtues merren me votën pro të 3/4 të anëtarëve që do të jenë të pranishëm në mbledhje, me kusht që të respektohet kuorumi i pjesëmarrjes i përcaktuar në nenin 15 të këtij Statuti.

Votimi është i fshehtë, përveç rasteve të veçanta kur Bordi Drejtues mund të vendosë ndryshe. Çdo vendim i Bordit dhe procesverbalet përkatëse të mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Bordit dhe një punonjës i stafit i caktuar nga Drejtori Ekzekutiv kryen detyrën e sekretarit teknik të Bordit Drejtues.

Në të gjitha rastet e procesit të vendimmarrjes të Bordit Drejtues, kur ka barazim votash apo kur nevojitet, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

NENI 25

DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv është organ individual, i cili përcaktohet në Statut në emërimet e para dhe ka të drejtë rizgjedhjeje të pakufizuar.

Drejtor Ekzekutiv i Qendrës është JONILA GODOLJA. Drejtori ekzekutiv është emëruar për një periudhe trevjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 26

KOMPETENCAT E DREJTORIT EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij:

- Administrimin e veprimtarisë së përditshme të Qendrës në zbatim të Statutit, vendimeve të Bordit Drejtues dhe legjislacionit në fuqi;

- Është përfaqësues ligjor i Qendrës;
- Realizon dhe ekzekuton programet e vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës;
- Përgatit projektprogramin vjetor të veprimtarive dhe projektbuxhetin e Qendrës, të cilat ia paraqet për miratim Bordit Drejtues dhe më pas kontrollon zbatimin e tyre;
- Lidh kontratat e punës me stafin e Qendrës duke përdorur metodën e konkurrimit të hapur e të lirë, sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi Drejtues;
- Përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë, brenda dhe jashtë vendit;
- Miradministron mjetet në pronësi të Qendrës;
- Merr vendime në përputhje me prioritetet e përcaktuara së bashku me Bordin e Drejtorëve;
- Merr vendime në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me drejtimin e Qendrës;
- Çdo detyrë tjetër që sipas ligjit ose nga Statuti nuk përbën kompetencë të Bordit të Drejtorëve dhe që lidhet me zbatimin e qëllimit të Qendrës.

NENI 27

BASHKIMI DHE NDARJA E QENDRËS

Qendra, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv dhe me miratimin e dhënë nga anëtarët e Bordit Drejtues, për arsye të lehtësirave që mund të krijohen nga bashkëpunimi gjithmonë në të mirë të arritjes së objektivave të Qendrës, mund të bashkohet ose të transformohet me organizata të tjera jofitimprurëse pa anëtarësi. Qendra konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

NENI 28

LIKUIDIMI

Kur vendoset shpërndarja e Qendrës, Bordi Drejtues cakton një ose disa likuidues të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasuritë dhe përfaqësimin e Qendrës që nga data e emërimit të tyre e deri në përfundim të likuidimit.

Likuiduesit e kryejnë veprimtarinë e tyre në bazë të nenit 47 të ligjit "Për organizatat jofitim-prurëse" dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Me emërimin e likuiduesit ose të likuiduesve, Drejtori Ekzekutiv nuk ka më funksione.

Kur shpërndarja e Qendrës vendoset me vullnet të lirë të Bordit Drejtues, ky organ kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit, miraton raportin përfundimtar të likuiduesit dhe i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për çregjistrimin e Qendrës. Nëse raporti përfundimtar i likuiduesve nuk miratohet nga Bordi Drejtues shqyrtohet nga Gjykata në prani të palëve. Likuiduesi ose likuiduesit emërohen me vendim të Bordit Drejtues.

NENI 29

VEPRIMTARIA E LIKUIDUESVE

Likuiduesi ose likuiduesit, brenda dy muajve nga data e emërimit të tyre, thërret mbledhjen e Bordit Drejtues, të cilit i paraqet raportin mbi gjendjen financiare të Qendrës, aktivin dhe pasivin e Qendrës para se të fillojë operacioni i likuidimit.

Likuiduesi përfaqëson Qendrën dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e pasivit të saj. Likuiduesi është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët dhe më pas vlerëson pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga Statuti.

NENI 30

DESTINIMI I PASURISË PAS SHPËRNDARJES SË QENDRËS

Pasuria e Qendrës pas shpërndarjes së saj do t'u kalojë në mënyrë proporcionale të gjitha organizatave joqeveritare homologe, të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë objekt të ngjashëm ose fusha veprimtarie të përbashkëta.

Përfshirë nga ky rregull përbëjnë të gjitha Organizatat me të cilat Qendra ka pasur projekte dhe programe të përbashkëta, të cilave në mënyrë preferenciale u kalon 40% e aktivitetit.

NENI 31

DISPOZITA TRANZITORE

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis anëtarëve të Bordit Drejtues apo me struktura të tjera të Qendrës do të bëhen përpjekje që të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre. Në të kundërt ato do t'i shtrohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut u hartua në katër ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Pas leximit dhe gjetjes në rregull ai nënshkruhet me vullnet të plotë pa vërejtje nga përfaqësuesit e themeluesve të Qendrës.

THEMELUESIT e Qendrës

JONILA GODOLJA

SONILA DANAJ

MATILDA ALKU